



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.59

18 maj

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.276, datë 9.5.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit të furnizimit me ujë nga rezervuari i Manskurisë, Golem.....	1531
Vendim i KM nr.279, datë 18.4.2007	Për miratimin e listës së produkteve të ndërtimit, për të cilat kërkohet vlerësimi i detyruar i konformitetit	1532
Vendim i KM nr.283, datë 9.5.2007	Për përcaktimin e procedurave të shitjes me ankand të objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të zakonshme..	1542
Vendim i KM nr.285, datë 4.5.2007	Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë, të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik të tyre.....	1546
Udhëzim i MB&MBUMK nr.7, datë 3.5.2007	Mbi kontrollin dhe monitorimin e subjekteve që mbjellin kërp industrial	1590
Udhëzim i MF nr.7, datë 7.5.2007	Për përdorimin e fondit të shpronësimeve.....	1591
Urdhër i MMPAU nr.155, datë 11.5.2007	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Nartë)	1594
Vendim i KKRT nr.585, datë 27.4.2007	Mbi reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat kombëtar “TV Arbëria”	1594

Vendim i KKRT nr.587, datë 27.4.2007	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv kabllor privat “APT”	1596
Vendim i ERE nr.30, datë 11.5.2007	Për disa shtesa në rregulloren e procedurave të licencimit.....	1597

VENDIM
Nr.276, datë 9.5.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT TË
FURNIZIMIT ME UJË NGA REZERVUARI I MANSKURISË, GOLEM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit të furnizimit me ujë nga rezervuari i Manskurisë, Golem.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, z.Nazmi Sinarezi, të kompensohet në vlerë të plotë, për sipërfaqen 650 m², tokë bujqësore, me çmim 800 lekë/ m², me vlerë të përgjithshme 520 000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 520 000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 133 500 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohet nga Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë.
 6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit maj 2007.
 7. Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë, të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të përcaktuar në pikën 6.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARIT QË DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I REALIZIMIT TË
PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË NGA REZERVUARI I MANSKURISË, GOLEM**

Nr.	Emri	Zk	Nr.pas	Sip tokë bujqësore	Çmimi l/m ²	Vlera lekë	Vlera totale lekë
1.	Nazmi Riza Sinarez	2291	16/7	650	800	520 000	
	Shuma						520 000

Totali 520 000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë.

VENDIM
Nr.279, datë 18.4.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT, PËR TË CILAT
KËRKOHEM VLERËSIMIN I DETYRUAR I KONFORMITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9097, datë 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit” dhe të neneve 5, 6, 7 e 10 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së produkteve të ndërtimit dhe kryerjen e vlerësimit të detyruar të konformitetit, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Çdo person fizik e juridik, vendas dhe i huaj, që prodhon dhe tregon materiale ndërtimi, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përpara hedhjes në treg të tyre, duhet të kryejë vlerësimin e konformitetit, në rast se nuk janë të shoqëruara me markën e konformitetit.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Lidhja 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT QË I NËNËSHTROHEN VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
I. Produktet e ndërtimit për betonin dhe beton-armenë.		
1	Shtesat për beton, llaç dhe bojak. Shtesat e betonit. Pjesa 2: Përcaktimet, kërkesat, konformiteti, markimi dhe etiketimi.	S SH EN 934-2
2	Shtesat për beton, llaç dhe bojak (llaç për mbushje). Pjesa 3: Shtesat për llaçe të mureve. Përkufizimet, kërkesat, konformiteti markimi dhe etiketimi.	S SH EN 934-3
3	Elementët shtesë për beton, llaç dhe bojak (llaç për mbushje). Pjesa 4: Elementët shtesë për bojak për tirantat e paranderura. Përkufizimet, kërkesat, konformiteti, markimi dhe etiketimi.	S SH EN 934-4
4	Bloqe betoni për shtresë. Kërkesat dhe metoda të provave. (*)	S SH EN 1338
5	Pllaka betoni për shtresë. Kërkesat dhe metoda të provave. (*)	S SH EN 1339
6	Bordura prej betoni të trotuareve. Kërkesat dhe metoda të provave. (*)	S SH EN 1340
7	Produktet dhe sistemet për mbrojtjen dhe riparimin e strukturave të betonit. Përcaktimet, kërkesat, kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi i konformitetit. Pjesa 2: Sistemet e mbrojtjes së sipërfaqes për beton.	S SH EN 1504-2
8	Produkte të parafabrikuar betoni-arme, me inerte të lehtë, me struktura të hapura.	S SH EN 1520
9	Tubat dhe aksesorët prej betoni, prej betoni të armuar dhe prej betoni me fibra çeliku.	S SH EN 1916
10	Materiale inerte për prodhimin e betoneve.	S SH EN 12620
11	Produkt parafabrikate prej betoni. Elementë për rrethime.	S SH EN 12839
II. Produktet e ndërtimit për punimet e muraturës.		
12	Çimento. Pjesa 1: Përbërja, specifikimet dhe kriteret e konformitetit për çimenton e zakonshme.	S SH EN 197-1
13	Çimento. Pjesa 4: Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot me rezistencë të ulët për kohë të shkurtër.	S SH EN 197-4
14	Çimento për muraturë. Pjesa 1: Specifikime.	S SH EN 413-1

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
15	Gëlqere për ndërtim. Pjesa 1 : Përkufizime, specifikime dhe kriteri i konformitetit.	S SH EN 459-1
16	Specifikimet për njësitë e muraturës. Pjesa 1: Njësi murature prej argjile.	S SH EN 771-1
17	Specifikimet për elementët e muraturës. Pjesa 2: Njësi e muraturës prej silikati të kalçiumit(tullat silikate).	S SH EN 771-2
18	Specifikimet për njësitë e muraturës. Pjesa 3: Njësi murature prej agregatësh betoni. (Agregatë të rëndë e të lehtë)	S SH EN 771-3
19	Specifikimet për elementët e muraturës. Pjesa 4: Elementë muri prej betoni poroz.	S SH EN 771-4
20	Specifikimet për njësitë e muraturës. Pjesa 5: Njësi murature guri të fabrikuara.	S SH EN 771-5
21	Specifikime për llaç murature. Pjesa 1: Llaç i ngurtësuar dhe i suvatuar.	S SH EN 998-1
22	Specifikime për llaçin e muraturës. Pjesa 2: Llaç murature.	S SH EN 998-2
23	Çimento. Përbërja, specifikime dhe kriteret konformiteti për çimento speciale me termicitet të ulët.	S SH EN 14216
24	Çimento, Përbërja, specifikimet dhe kriteret e konformitetit për çimentot speciale me termicitet shumë të ulët.	S SH EN 14396
III. Produktet e drurit në ndërtim dhe konstruksionet prej lënde druri.		
25	Produkte për izolim termik të godinave. Produkte prej lesh druri.(WW) Karakteristikat.	S SH EN 13168
26	Pillaka me bazë druri për konstruksione. Karakteristikat, vlerësimi i konformitetit dhe markimi.	S SH EN 13986
IV. Produktet në ndërtim për konstruksione metalike.		
27	Kollona ndriçimi. Pjesa 5: Kërkesat për kollonat e ndriçimit prej çeliku.	S SH EN 40-5
28	Kolonat e ndriçimit. Pjesa 6: Kërkesat për kolonat e ndriçimit prej alumini.	S SH EN 40-6
29	Kolonat e ndriçimit. Pjesa 7:Kërkesat për fibrat e përforcuara me polimerë të përbërë të kolonave të ndriçimit	S SH EN 40-7
30	Veshjet me shirit çeliku për tendosjen e kablllove. Terminologjia, kërkesat, kontrolli i cilësisë.	S SH EN 523
31	Produkte të laminuar në të nxehtë prej çeliqesh për konstruksione, të palidhur. Kushtet teknike të lëvrimit.	S SH EN 10025-1

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
V. Materialet dhe produktet për izolimin termik, akustik, materiale të papërshkueshëm nga uji, lidhesat & mbrojtësat e ndryshëm.		
32	Produkte për izolim termik për ndërtesat. Produkte të fabrikuara prej leshi mineral. Specifikime.	S SH EN 13162
33	Produkte për izolim termik për ndërtesat. Prodhome polistireni të bymyer të fabrikuara. Karakteristikat.	S SH EN 13163
34	Produkte për izolim termik në ndërtim. Prodhome prej polistireni të shkumëzuara, të fabrikuara. Karakteristikat.	S SH EN 13164
35	Produkte për izolim termik të godinave. Produkte të prodhuara prej shkume të ngurtë prej poliuretani (PUR) Karakteristikat.	S SH EN 13165
36	Produkte për izolim termik të godinave. Shkumë fenolike. (PF) Karakteristikat.	S SH EN 13166
37	Produkte për izolim termik të godinave. Produkte të qelqit celular.(CG) Karakteristikat.	S SH EN 13167
38	Produkte për izolim termik për ndërtesa. Produkte të parafabrikuara prej perliti të bymyer. Specifikime.	S SH EN 13169
39	Produkte për izolim termik për ndërtesa. Produkte prej tape të bymyer, të fabrikuar (ICB). Karakteristikat.	S SH EN 13170
40	Produkte për izolim termik për ndërtesa. Produkte prej fibrash druri të fabrikuar (ICB). Specifikime.	S SH EN 13171
41	Lidhësit, lidhësit e përbërë dhe përzieriet e prodhuara në fabrikë me bazë sulfat kalçiumi për shtresat e holla. 1: Përcaktimet dhe kërkesat.	S SH EN 13454-1 Pjesa
42	Fletët fleksibël për hidroizolim. Fletët prej bitumi të armuar për hidroizolim hermetik. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13707
43	Fletë fleksibël për hidroizolim. Përcakimet dhe karakteristikat e nënshtresave. Pjesa 2: Nënshtresat për muret.	S SH EN 13859 -2
44	Fletë fleksibël për hidroizolim. Fletët plastike dhe prej gome për hermetizim të lagështisë, duke përfshirë fletën plastike dhe prej gome të bazamentit të depozitës. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13967

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
45	Fletët fleksibël për hidroizolim. Fletët prej bitumi për hermetizim të lagështisë, duke përfshirë fletët prej bitumi të bazamentit të depozitës. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13969
46	Fletë fleksibël për hidroizolim. Shtresat prej bitumi për kontrollin e avullit të ujit. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13970
47	Fletë fleksibël për hidroizolim. Shtresat plastike dhe prej gome për kontrollin e avullit të ujit. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13984
VI. Produktet e ndërtimit për impiantet inxhinierike të pastrimit të ujrave, lëngjeve dhe sistemet e shpërndarjes së gazit.		
48	Tubat prej fibre çimentoje për kullimin dhe shkarkimin e ujrave të zeza. Pjesa 2: Puseta e hyrjes dhe kontrollit.	S SH EN 588-2
49	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 1: Goma e vullkanizuar.	S SH EN 681-1
50	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 2: Elastomeret termoplastike.	S SH EN 681-2
51	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 3: Materialet celulare të gomës së vullkanizuar.	S SH EN 681-3
52	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 4: Elementet hermetizues prej poliuretani të derdhur.	S SH EN 681-4
53	Guarnicione elastomerë. Kërkesat e materialeve për guarnicionet që përdoren në tuba dhe rakorderitë që transportojnë gaz dhe hidrokarburë të lëngët.	S SH EN 682
54	Tubat dhe rakorderitë e tubave prej çeliku të galvanizuar në të nxehtë dhe me saldim gjatësor, me bokull bashkuese për sistemet e ujrave të shkarkimit. Pjesa 1: Kërkesat, provat, kontrolli i cilësisë. (*)	S SH EN 1123-1
55	Tubat dhe rakorderitë e tubave prej çeliku inoksidabël dhe me saldim gjatësor, me bokull bashkuese për sistemet e ujrave të shkarkimit. Pjesa 1: Kërkesat, provat, kontrolli i cilësisë. (*)	S SH EN 1124-1
56	Ventilat e futjes së ajrit për sistemet e drenazhimit. Kërkesat, metodat e provës dhe vlerësimi i konformitetit. (*)	S SH EN 12380
57	Sisteme të vogla të trajtimit të shkarkimeve ujore për deri 50pt. Pjesa 1: Rezervuarë septikë të parafabrikuar.	S SH EN 12566-1

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
58	Sistemet për zbulimin e rrjedhjeve. Pjesa 1: Parime të përgjithshme.	S SH EN 13160-1
59	Gjeotekstilet dhe produktet që kanë lidhje me gjeotekstilet. Karakteristikat që kërkohen për përdorimin në projektet e depozitimeve të mbeturinave të lëngëta.	S SH EN 13265
60	Lidhëse për veshje izoluese magnezite. Hidroksid magnezi dhe klorur magnezi. Pjesa 1: Përcaktimet, kërkesat	S SH EN 14016-1
VII. Materiale speciale, produkte, strukturat dhe pajisje të ndryshme.		
61	Tjegulla dhe elementë betoni, specifikimet e prodhimeve.	S SH EN 490
62	Laminat dekorativ të presionit të lartë (HPL). Fletë me bazë rrëshirat termodore. Pjesa 1: Specifikimet.	S SH EN 438-7
63	Specifikimet për komponentët ndihmës të muraturës. Pjesa 1: Lidhësë, rripa(breza) tensioni, çengela dhe konsola.	S SH EN 845-1
64	Specifikimet për komponentët ndihmës të muraturës. Pjesa 2: Arkitrarët.	S SH EN 845-2
65	Specifikimet për komponentët ndihmës të muraturës. Pjesa 3: Shtrati lidhës i përforcimit prej çeliku.	S SH EN 845-3
66	Materialet për shenjat në rrugë. Reflektuese të vendkalimeve të rrugës. Pjesa 1: Kërkesat e performancës fillestare.	S SH EN 1463-1
67	Lidhësat për pllaka. Përkufizime dhe specifikime.	S SH EN 12004
68	Shtresa kundër shkëlqimit verbues të rrugëve. Pjesa 1: Performanca dhe karakteristikat.	S SH EN 12676-1
69	Ngjitësit me bazë gipsi për blloqet prej gipsi. Përkufizimet, kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 12860
70	Agregatë për përzierje bituminoze dhe trajtime sipërfaqësore për rrugë Aeroporte dhe zona të tjera të trafikut.	S SH EN 13043
71	Agregatë të lehtë. Pjesa 1: Agregatë të lehtë për beton dhe llaç.	S SH EN 13055-1
72	Inerte të lehtë. 1: Inerte të lehtë për përzierje bituminoze dhe për trajtimin e sipërfaqeve si dhe për përdorime me lidhësa dhe pa lidhësa. Pjesa	S SH EN 13055-2
73	Agregate për llaçe.	S SH EN 13139

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
74	Agregatë për materiale lidhës hidraulik dhe jolidhës për përdorim në industrinë civile dhe ndërtimin e rrugëve.	S SH EN 13242
75	Agregate për çakëllin (ballastin) e hekurudhave.	S SH EN 13450
VIII. Mbrojtja nga zjarri dhe siguria në shtëpi.		
76	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 3: Sistemet zanore të alarmit të zjarrit.	S SH EN 54-3
77	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 4: Pajisjet për furnizim elektrik.	S SH EN 54-4
78	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 5: Zbuluesit e ndjeshëm ndaj nxehtësisë. Zbuluesit në majë.	S SH EN 54-5
79	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 7: Zbuluesit e tymit. Zbuluesit me majë të cilët përdorin dritë të përhapur, dritë të transmetuar ose jonizim.	S SH EN 54 -7
80	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 12: Zbuluesit e tymit. Zbuluesit në linjë, të cilët përdorin një tufë rrezesh optike.	S SH EN 54-12
81	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 1 : Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet elektrike të kontrollit automatik dhe për shërbimet e vonimit. (*) Dalluesit e veçantë të zjarrit.	S SH EN 12094-1
82	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 2 :Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet joelektrike të kontrollit (*)	S SH EN 12094-2
83	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 3: Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet manuale dhe të ndalimit. (*)	S SH EN 12094-3
84	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 4 : Kërkesat dhe metodat e provave për bashkësitë e valvolave. (*)	S SH EN 12094-4 - —
85	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 9 : Kërkesat dhe metodat e provave për dalluesit e veçantë të zjarrit. (*)	S SH EN 12094-9
86	Sistemet shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 10 : Kërkesat dhe metodat e provave për manometrat e presionit dhe për kontaktet me presion. (*)	S SH EN 12094-10

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
87	Sistemet e shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 11 : Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet mekanike të peshimit. (*)	S SH EN 12094-11
88	Sistemet e shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 12: Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet pneumatike të alarmit. (*)	S SH EN 12094-12
89	Sistemet e kontrollit të tymit dhe nxehtësisë. Pjesa 2: Specifikimet për ventilatorët e tymit të zakonshëm dhe të nxehtësisë.	S SH EN 12101-2
90	Sistemet e kontrollit të tymit dhe nxehtësisë. Pjesa 3: Specifikime për ventilatorët e tymit të fuqishëm dhe të nxehtësisë.	S SH EN 12101-3
91	Sistemet e palëvizshme të fikjes së zjarrit. Pjesa 1: Përbërësit për sistemet e spërkatjes me ujë. Spërkatësit.	S SH EN 12259-1
92	Sisteme zjarrfikëse të fiksuar. Përbërës për spërkatje (shi i imët) dhe sisteme ujore spërkatëse. Pjesa 2: Valvolat sinjalizuese të lagështisë	S SH EN 12259-2
93	Sisteme zjarrfikëse të fiksuar. Përbërës për spërkatje (shi i imët) dhe sisteme ujore spërkatëse. Pjesa 3: Valvolat sinjalizuese të thatësisë.	S SH EN 12259-3
94	Sisteme zjarrfikëse të fiksuar. Përbërës për spërkatje (shi i imët) dhe sisteme ujore spërkatëse. Pjesa 4: Alarmet motorike ujore.	S SH EN 12259-4
95	Sisteme e palëvizëshëm të fikjes së zjarrit. Pjesa 5: Dedektorët me rryme uji.	S SH EN 12259-5
96	Sistemet e palëvizshëm të fikjes së zjarrit. Pjesa 1: Sistemet me pluhurosje. Kërkesat dhe metodat e provës për përbërësit. (*)	S SH EN 12416-1
97	Sistemet e palëvizshëm të fikjes së zjarrit. Pjesa 2: Sistemet me pluhurosje. Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja.	S SH EN 12416-2
98	Sistemet e palëvizshm të fikjes së zjarrit. Sistemet me shkumë. Pjesa 1: Kërkesat dhe metodat e provave për përbërësit. (*)	S SH EN 13565-1
IX. Pajisje teknike të ndërtimit.		
99	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet për daljet e emergjencës, të cilat vihen në lëvizje me anë të një doreze-levë ose të një pllake që shtypet. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 179
100	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet për daljet e emergjencës dhe kundra panikut, të cilat komandohen me anë të një doreze horizontale. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1125

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
101	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet me amortizim për mbylljen e derës. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1154
102	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet mbajtëse-hapëse elektrike për dyert rrotulluese. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1155
103	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet kordinuese të dymve. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1158
104	Materialet për shenjat në rrugë Hedhja e materialeve. Zbukurimet prej xhami, pajisjet kundër rrëshqitjes dhe përzierësit e dy komponenteve.	S SH EN 1423
105	Pajisje për ndërtim. Çengela (ngritësa) me një aks, kërkesat dhe metodat e provave.	S SH EN 1935
106	Dyer garazhesh dhe porta hyrje. Produkt standard. Pjesa 1: Produkte pa karakteristika kontrolli të rezistencës ndaj zjarrit dhe tymit.	S SH EN 13241-1
107	Agregatë të lehtë. Pjesa 1: Agregatë të lehtë për beton dhe llaç.	S SH EN 13055-1
108	Agregate për llaç.	S SH EN 13139
109	Agregatë për materiale hidraulikisht lidhës dhe jolidhës për përdorim në industrinë civile dhe ndërtimin e rrugëve.	S SH EN 13242
110	Agregate për çakëllin(ballastin) e hekurudhave.	S SH EN 13450
111	Materiale nivelues dhe niveluesit për dysheme. Materiale niveluese. Vetitë dhe kërkesat.	S SH EN 13813
112	Pajisje të parandalimit të mbimbushjes për tankerat e palëvizshëm për lëndë djegëse të lëngëta.	S SH EN 13616
113	Radiator dhe konvektor. Pjesa 1: Karakteristika termike dhe kërkesat.	S SH EN 442-1
114	Panele radiatore të montuara në tavan, të furnizuar me ujë me temperaturë 1200 °C Pjesa 1: Specifikime teknike dhe kërkesa	S SH EN 14037-1
115	Aparatura prej guri. Pjesa 1: Specifikimet.	S SH EN 13383-1
116	Kushinetat e strukturës. Pjesa 4: Kushineta me rula	S SH EN 1337-4
117	Kushinetat e strukturës. Pjesa 6: Kushineta me çernierë	S SH EN 1337-6

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
118	Kushinetat e strukturës. Pjesa 7: Kushineta sferike dhe cilindrike prej PTFE	S SH EN 1337-7
119	Ashensorët për ndërtesat. Bravat dhe shula. Bravat , shulat dhe pllakat mbyllëse mekanike. Kërkesat dhe metodat e provave.	S SH EN 12209
120	Pajisje kundër përmbytjeve në ndërtesa. Pjesa 1: Kërkesat.	S SH EN 13564-1
121	Dyer garazhdesh dhe porta hyrje. Produkt standard. Pjesa 1: Produkte pa karakteristika kontrolli të rezistencës ndaj zjarrit dhe tymit.	S SH EN 13241-1
122	Grila të jashtëm. Kërkesat e performancës përfshirë dhe sigurinë	S SH EN 13561
123	Grila. Kërkesat e performancës përfshirë dhe sigurinë.	S SH EN 13659
X. Produktet e ndërtimit për paretet e jashtme e të brendshme, tavane, dysheme.		
124	Pllaka prej guri natyror për shtresë të jashtme. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1341
125	Kalldrëmet prej guri natyror për shtresa të jashtme. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1342
126	Bordurat prej guri natyror për shtresa të jashtme. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1343
127	Pllaka argjili për shtrim. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1344
128	Kanale kullimi për zona kalimi për këmbësorë dhe mjete. Klasifikimi, kërkesat për projektim dhe prova markimi dhe vlerësimi i konformitetit.	S SH EN 1433
129	Pllaka për tarraca. Pjesa 2: Pllake tarrace për përdorim të jashtëm.	S SH EN 13748-2
130	Pllaka qeramike. Përkufizime,klasifikime,karakteristika dhe markimi.	S SH EN 14411
131	Produkte guri dhe eterniti për çati dhe veshje(mbulesa) Pjesa 1: Specifikimet e produktit	S SH EN 12326-1
132	Tavanë të varur. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 13964
133	Oxhakët Veshjet e brendshme prej qeramike e oxhakut. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1457

Nr. Rendor	Emërtimi i familjes së produktit	Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të
134	Oxhakët. Kërkesat për oxhaqet metalikë. Pjesa 1: Produktet e sistemit të oxhakut.	S SH EN 1856-1
135	Oxhakët. Kërkesat për oxhaqet metalikë. Pjesa 2: Lidhjet forcuese metalike dhe lidhëset e tubave të aspirimit.	S SH EN 1856-2
136	Oxhakët. Komponentët. Bloqe prej betoni të grykës.	S SH EN 1858
137	Oxhakët. Komponentët. Veshjet e grykës së shkarkimit prej betoni.	S SH EN 1857
138	Oxhakët. Kërkesat dhe metodat e provave për grykat e shkarkimit prej qeramike (*)	S SH EN 13502
139	Përbërësit e oxhaqeve. Elementët e pareteve të jashtme të betoneve.	S SH EN 12446
XI. Produktet e ndërtimit për instalime sanitare.		
140	Depozitat e WC dhe kompletet e WC me sifon integral.	S SH EN 997
141	Dhoma inspektimi dhe puse lidhjesh prej betoni të pa armuar me shufra hekuri dhe të armuara.	S SH EN 1917
142	Lavamanët e kuzhinës. Kërkesat e funksionimit dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 13310

Shënim: (*) Kërkesat dhe Metoda e Provave janë përfshirë në këtë listë, pasi ato janë Standarde të përbashkëta dhe të harmonizuara me kërkesat.

VENDIM Nr.283, datë 9.5.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHITJES ME ANKAND TË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TË LUAJTSHME, ME VLERA TË ZAKONSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 20 të ligjit nr.9048, datë 7.3.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e procedurave të shitjes me ankand të objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të zakonshme.

I. Kushtet e zhvillimit të procedurës së ankandit

1. Institucionet publike të trashëgimisë kulturore materiale, ku bëjnë pjesë muzetë kombëtarë, vendorë, tipologjikë apo në varësi të Akademisë së Shkencave, të cilët kanë në administrim objekte të luajtshme, pronë shtetërore, të trashëgimisë kulturore, me vlera të zakonshme, organizojnë ankand të hapur për shitjen e këtyre objekteve.

2. Ankandi zhvillohet në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, në kushtet e

sigurisë dhe të ekspozimit të hapur të objekteve për pjesëmarrësit. Muzeu Historik Kombëtar merr të gjitha masat për ruajtjen e përkohshme të objekteve, që do të dalin në ankand, gjatë periudhës përgatitore deri në përfundimin e tij dhe dorëzimin e objektit/eve të pronari i ri, në përputhje me këtë vendim.

3. Procedurat e ankandit zhvillohen nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

4. Objektet, që i nënshtrohen procedurës së ankandit, duhet të jenë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore (në vijim QKIPK), si dhe të jenë pajisur me pasaportën përkatëse, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

5. Drejtuesi i institucionit, që ka në administrim objektet, që do t’i nënshtrohen procedurës së ankandit, paraqet në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kërkesën me shkrim, për shitjen me ankand të objektit/eve, të shoqëruar me një relacion të hollësishëm, ku argumentohen arsyet e shitjes, dhe me pasaportën për çdo objekt. Në kërkesë përcaktohet edhe vlera fillestare e objektit/eve.

6. Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, pasi shqyrton kërkesën e institucionit të interesuar, brenda 20 ditëve nga data e protokollit të saj, i paraqet Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve vlerësimin, me shkrim, për këtë kërkesë, pasi ka marrë më parë mendimin, me shkrim, të institucionit të specializuar, sipas pikës 7 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, në përputhje me natyrën e objektit/eve, që kërkohet/en të shitet/en, nëse ato janë me vlera të zakonshme.

7. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pasi shqyrton kërkesën dhe vlerësimin e Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore, miraton ose jo fillimin e procedurës së ankandit.

8. Në rastin kur Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka miratuar kërkesën për shitjen me ankand të objektit/eve, nxjerr urdhër për fillimin e procedurave të ankandit dhe për ngritjen e komisionit për zhvillimin e kësaj procedure.

9. Komisioni i ngritur për këtë qëllim përgatit dokumentacionin, i cili përveç dokumenteve të përmendura në kreun III të këtij vendimi, përmban edhe:

a) Urdhrin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për fillimin e procedurave të ankandit.

b) Vërtetimin e QKIPK-së se objektet janë të regjistruara në këtë Qendër.

c) Pasaportën e secilit objekt.

ç) Vlerën fillestare të ankandit për secilin objekt, të propozuar nga institucioni që ka në administrim objektin/et, vlerë e cila duhet të jetë e njëjtë ose më e madhe se vlera financiare, e përshkruar në pasaportën e objektit.

d) Urdhrin përkatës të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për lëvizjen e objektit/eve nga institucioni, që i ka në administrim, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, sipas nenit 19/1 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe masat për ruajtjen e tyre.

II. Njoftimi

1. Komisioni i zhvillimit të procedurës së ankandit të hapur, pas plotësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, kur e gjen të rregullt, bën shpalljen e njoftimit të ankandit për objektin/et, në dy ditë të njëpasnjëshme, në dy gazeta të përditshme, me tirazh kombëtar, si dhe në Buletinin e radhës së Njoftimeve Publike.

2. Subjektet e ndryshme, me anë të njoftimit, vihen në dijeni për mënyrën e sigurimit të dokumentacionit, të të dhënave të tjera, më të hollësishme, dhe për mënyrën e paraqitjes së ofertave.

Njoftimi përmban:

a) emërtesën e objektit;

b) çmimin fillestar;

c) të dhëna të përgjithshme për objektin/et;

ç) adresën e institucionit publik, që ofron objektin/et;

d) adresën e vendit, ku do të tërhiqen dokumentet e ankandit;

dh) formularin e ofertës;

e) çmimin e blerjes së dokumenteve;

ë) garancinë e ofertës, vërtetimin bankar ose vërtetimin nga shoqëri sigurimi, të licencuara;

f) vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;

g) të dhëna të tjera, të çmuara si të domosdoshme nga komisioni për ofertuesit.

3. Data e zhvillimit të ankandit duhet të jetë jo më parë se 30 ditë nga data e njoftimit të ankandit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Pas shpalljes së njoftimit të ankandit për shitjen e objektit/eve ndalohet të bëhet çdo ndryshim i mëtejshëm në dokumentacion.

5. Të interesuarit e marrin dokumentacionin dhe të dhënat e tjera pranë komisionit, të ngritur sipas pikës 3 të kapitullit I të këtij vendimi.

III. Dokumentet e nevojshme

Dokumentet e nevojshme janë:

1. Ftesa për pjesëmarrje në ankand është letra shoqëruese e dosjes së plotë të dokumenteve të ankandit, që bën përsëritjen e tekstit të njoftimit, drejtuar të interesuarve.

2. Garancia bankare është dokumenti bankar i pagesës paraprake, në lekë, si mandatar-këtim, urdhër-xhirim apo garanci bankare, për 30 për qind të vlerës fillestare të ankandit.

3. Dokumentet për paraqitjen e ofertës, që nënkuptojnë:

i) njoftimin e ftesës;

ii) të dhënat e përgjithshme për procedurën e ankandit;

iii) udhëzimet për ofertuesin;

iv) kualifikimin e ofertuesve, pjesëmarrës në ankand, kushtet, administrative dhe ligjore, që duhet të plotësojnë;

v) mënyrën e vlerësimit të ofertave;

vi) informacionin për ankimet administrative në dispozicion të ofertuesve;

vii) nënshkrimin e kontratës;

viii) shtojcat e mundshme, sipas objektit të ankandit.

Dokumentet paraqiten në dy kopje, në zarfe të veçanta, në shqip, të nënshkruara dhe vulosura nga ofertuesi.

IV. Përbërja e komisionit të ankandit dhe zhvillimi i tij

1. Komisioni i ankandit ka në përbërje:

- Një nëpunës të lartë drejtues, në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve kryetar;

- Një përfaqësues të Drejtorisë së Trashëgimisë

Kulturore, në Ministrinë e Turizmit, Kulturës,

Rinisë dhe Sporteve anëtar;

- Përfaqësuesin e institucionit, që ofron objektet për shitje anëtar;

- Një përfaqësues të QKIPK-së anëtar;

- Një përfaqësues për kulturën popullore nga

institucionet e specializuara anëtar;

- Një përfaqësues të Galerisë së Arteve anëtar;

- Një përfaqësues për arkeologjinë nga institucionet

e specializuara anëtar;

- Një ekonomist të Ministrisë së Turizmit,

Kulturës, Rinisë dhe Sporteve anëtar;

- Një jurist të Ministrisë së Turizmit, Kulturës,

Rinisë dhe Sporteve anëtar.

Në këtë komision marrin pjesë, pa të drejtë vote, me statusin e vëzhguesit, edhe përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara.

Anëtarët e komisionit të ankandit, para zhvillimit të tij, deklarojnë dhe nënshkruajnë se nuk kanë konflikt interesi, në kuptim të ligjit nr.9376, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

2. Anëtarët e komisionit të ankandit kanë përgjegjësi për mospjesëmarrje të pajustificuar në ankand, në datën dhe në orën e caktuar.

3. Komisioni i ankandit merr vendime me votat e shumicës së të gjithë anëtarëve. Kur nuk sigurohet pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të komisionit, ankandi zhvillohet, por jo me më pak se 5 anëtarë, me të drejtë vote. Në rast barazimi, vota e kryetarit të komisionit është përcaktuese.

4. Ankandi është i vlefshëm kur, në datën dhe orën e shpallur për zhvillimin e tij, paraqiten jo

më pak se dy ofertues.

Oferta, me vlerë më të ulët se vlera e shpallur e çmimit të ankandit, shpallet e pavlefshme dhe skualifikohet nga komisioni.

5. Komisioni i ankandit ka për detyrë:

a) të paraqesë anëtarët e komisionit te pjesëmarrësit;

b) të deklarojë vlerën fillestare të objektit/eve në ankand;

c) të hartojë dokumentacionin për ecurinë e ankandit, ku përfshihen procesverbali dhe raporti për përfundimin e ankandit.

Procesverbali i zhvillimit të ankandit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të komisionit dhe nga pjesëmarrësit në ankand ose përfaqësuesit e tyre, të pajisur me prokurë.

6. Fituesi i ankandit shpallet deklaruesi i çmimit më të lartë dhe njoftimi i fituesit botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, nëse brenda 5 ditëve, pjesëmarrësit në ankand nuk kanë paraqitur ankim, me shkrim, kundër vendimit të komisionit për shpalljen e fituesit të ankandit.

7. Fituesi i ankandit është i detyruar të nënshkruajë kontratën dhe të bëjë pagesën e plotë të vlerës së dhënë në ofertën e vet, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Pas lidhjes së kontratës, ofertuesve të tjerë u çlirohet garancia bankare, prej 30 përqindësh, të vlerës fillestare të objektit/objekteve, të vëna në shitje.

9. Fituesit e ankandit, që nuk kryejnë pagesën e plotë, brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij kreu, si edhe në rastet kur ai tërhiqet brenda këtij afati, i mbahet, si e ardhur në buxhet garancia bankare paraprake, prej 30 përqindësh, e paguar për pjesëmarrje në ankand. Pas këtij afati, komisioni i ankandit përsërit procedurën, duke filluar me rishpalljen e njoftimit të ankandit, sipas së njëjtës procedurë.

10. Pasi blerësi bën pagesën brenda afatit të parashikuar, drejtuesi i institucionit, që ka ofruar për shitje objektin/et, i dorëzon fituesit objektin/et, për të cilat është bërë më parë regjistrimi i ndryshimit të pronësisë, në bazë të të dhënave të QKPIK-së, së bashku me pasaportën përkatëse.

11. Në rast se në ditën e shpallur të ankandit nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës ose numri i tyre është më pak se numri i lejuar në këtë vendim, komisioni njofton drejtuesin e institucionit, që ka ofruar objektin/et në ankand, i cili duhet të shprehet për përsëritjen e procedurave të ankandit dhe i propozon ministrit përkatës nxjerrjen e urdhrin të ri të ankandit.

V. Ankimi dhe afatet

1. Çdo subjekt pjesëmarrës, që ka ose ka pasur interes në një procedurë ankandi, i dëmtuar ose që rrezikon të dëmtohet nga një vendim i komisionit, i marrë në kundërshtim me rregullat e ankandit, ka të drejtën e ankimit me shkrim ndaj këtij vendimi.

2. Ankimi i paraqitet, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për vendimin, kryetarit të komisionit të ankandit, i cili, pasi shqyrton ankimin dhe shkeljen e pretenduar, vendos pranimin ose jo të kërkesës, brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për vendimin e kryetarit të komisionit të ankandit, subjekti mund të paraqesë ankim te Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

4. Ministri, së bashku me strukturat përkatëse, shqyrton ankimin dhe merr vendim, brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Vendimi i Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përfundimtar dhe mund të ankimohet në gjykatë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi.

VI. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe titullarët e institucioneve publike, të përcaktuara në pikën 1 të kreut I, për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që në zbatim të këtij vendimi, të miratojë formatin tip të dokumenteve për paraqitjen e ofertës, sipas përcaktimit në kreun III të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.285, datë 4.5.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS REFERUESE MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE, SIPAS NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARISË EKONOMIKE, PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN JOPUBLIK, QË KRYEJNË PUNË, TË PAKUALIFIKUARA E TË KUALIFIKUARA, SI DHE PËR PERSONELIN DREJTUES E TEKNIKO-EKONOMIK TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007” dhe të nenit 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kur administrata tatimore vëren se pagat e deklaruara nga punëdhënësit jopublikë, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale të të punësuarve të tyre, nuk janë reale dhe nuk i përgjigjen vlerës së tregut për shërbimet e punësimit, ajo ka autoritetin t’i rivlerësojë, sipas niveleve të pagave, të dhëna në këtë vendim.

2. Paga referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat personale për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik, sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike dhe të kërkesave të vendit të punës për kualifikim, përcaktohet në seksionet A deri në O dhe në nënndarjet, sipas klasifikimit në tri kategori të rretheve, ku ushtrohet veprimtaria e biznesit (tabelat, që i bashkëlidhen këtij vendimi). Për degët e naftës, hotelerinë dhe peshkimin administrata tatimore mund të zbatojë pagën referuese të pozicionit “Administrator/drejtor i përgjithshëm” të rrethit të Tiranës, për të njëjtin pozicion për subjektet, që ushtrojnë veprimtari në rrethet e kategorisë së dytë e të tretë.

3. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

a) “Punë e pakualifikuar apo me kualifikim të ulët” punët, që nuk kërkojnë kualifikim paraprak apo që mund të kryhen nga një punëmarrës, i cili mund të mos e ketë kryer ndonjëherë atë punë. Këtu përfshihen, pa u kufizuar vetëm në to, punë të tilla, si pastrues, korrier, shitës, kamerier, paketues, lavazhier, përgatitës llaçi me krahë, transportues me krahë, punëtor ngarkim-shkarkimi me krahë, punëtor për gërmim toke me krahë, qepës cope e lëkure, si dhe punëtorë për punë të ngjashme.

b) “Punë e kualifikuar” punët apo profesionet, që kërkojnë aftësim profesional dhe që nuk mund të kryhen nga një punëmarrës pa kualifikim paraprak apo që nuk e ka ushtruar ndonjëherë atë punë a profesion. Njohuritë e shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar, për një specialitet të dhënë, mund të jenë fituar nga punëmarrësi përkatës, nëpërmjet arsimit profesional, kurseve të formimit profesional apo dhe gjatë praktikës. Punëmarrësit, që punojnë në punë të kualifikuara, si:

SEKSIONI I : TRANSPORTET, DHE KOMUNIKACIONI								
60	TRANSPORTI TOKESOR							
60.2	Transporte te tjera tokesore (urban, dhe rrugor)	90.000	50.000	60.000	45.312	29.736	24.780	15.000
60.21	Transporti i rregullt i udhetareve	90.000	50.000	60.000	54.000	35.700	29.400	15.000
60.22	Transporti i udhetareve me taksi	90.000	50.000	60.000	44.400	29.400	24.780	15.000
60.24	Transporti rrugor i mallrave	90.000	50.000	60.000	48.000	31.500	26.250	15.000
61	TRANSPORTI UJOR							
61.1	Transport detar dhe bregdetar	90.000	50.000	60.000	55.200	35.700	30.030	15.000
61.2	Transporti i brendshem ujq	90.000	50.000	60.000	42.000	31.500	26.250	15.000
62	TRANSPORTI AJROR							
62.1	Transporti ajror ne linja te rregullta	90.000	50.000	60.000	55.200	35.700	30.030	15.000
63	SHERBIME NDIHMESE NE TRANSPORT;							
	AKTIVITETE TE AGJENCIVE TE UDHETIMIT							
63.1	Ngarkim shkarkimi i mallrave dhe depozitimi i tyre	90.000	50.000	60.000	48.000	31.500	26.250	15.000
63.2	Administrimi i infrastrukturave te transportit	90.000	50.000	60.000	55.200	35.700	30.030	15.000
63.3	Aktivitetet e agjensise te udhetimit dhe te turizmit	90.000	50.000	60.000	57.600	37.800	31.500	15.000
63.4	Aktivitetet e agjensise te tjera te transportit (organizimi i transportit te mallrave)	90.000	50.000	60.000	55.200	35.700	30.030	15.000
64	POSTAT DHE KOMUNIKACIONET							
64.1	Aktivitetet e postes dhe te korieve	90.000	50.000	60.000	44.400	28.350	24.150	15.000
64.2	Telekomunikacionet	90.000	50.000	60.000	61.200	39.900	33.600	15.000

KATEGORIA III: Rrethet e tjera

SEKSIONI I : TRANSPORTET, DHE KOMUNIKACIONI								
60	TRANSPORTI TOKESOR							
60.2	Transporte te tjera tokesore (urban, dhe rrugor)	60.000	35.000	40.000	37.760	28.320	23.600	14.000
60.21	Transporti i rregullt i udhetareve	60.000	35.000	40.000	45.000	34.000	28.000	14.000

	60.22	Transporti i udhetareve me taksi	60.000	35.000	40.000	37.000	28.000	23.600	14.000
	60.24	Transporti rrugor i mallrave	60.000	35.000	40.000	40.000	30.000	25.000	14.000
61		TRANSPORTI UJOR							
	61.1	Transport detar dhe bregdetar	60.000	35.000	40.000	46.000	34.000	28.600	14.000
	61.2	Transporti i brendshem ujq	60.000	35.000	40.000	35.000	30.000	25.000	14.000
62		TRANSPORTI AJROR							
	62.1	Transporti ajror ne linja te rregullta	60.000	35.000	40.000	46.000	34.000	28.600	14.000
63		SHERBIME NDIHMESE NE TRANSPORT;							
		AKTIVITETE TE AGJENCIVE TE UDHETIMIT							
	63.1	Ngarkim shkarkimi i mallrave dhe depozitimi i tyre	60.000	35.000	40.000	40.000	30.000	25.000	14.000
	63.2	Administrimi i infrastrukturave te transportit	60.000	35.000	40.000	46.000	34.000	28.600	14.000
	63.3	Aktivitetet te agjensise te udhetimit dhe te turizmit	60.000	35.000	40.000	48.000	36.000	30.000	14.000
	63.4	Aktivitetet te agjensise te tjera te transportit (organizimi i transportit te mallrave)	60.000	35.000	40.000	46.000	34.000	28.600	14.000
64		POSTAT DHE KOMUNIKACIONET							
	64.1	Aktivitetet e postes dhe te koreve	60.000	35.000	40.000	37.000	27.000	23.000	14.000
	64.2	Telekomunikacionet	60.000	35.000	40.000	51.000	38.000	32.000	14.000

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Drejtor Administrator		Drejtues te degeve, njesive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialiste ne zbatim	Puntore te kualifikuar	Puntore te pakualifiku ar
				DTM	Subjekte te tjera	DTM	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I Rrethi TIRANE										
SEKSIONI J/K: NDERMJETESIMI FINANCJAR, PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA,DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERRMARJEVE										

65			SEKSIONI J: NDERMJETESIMI FINANCJAR							
			NDERMJETESIMI FINANCJAR PERVEC AKTIVITETETEVE							
			TE SIGURIMIT DHE ARKAVE TE PENSIONEVE							
	65.1		Ndermjjetesimi monetar	500.000	90.000	100.000	51.600	35.200	29.700	17.000
	65.2		Ndermjjetesime te tjera financiare	150.000	80.000	90.000	51.600	35.200	29.700	17.000
66			AKTIVITETE TE SIGURIMIT, DHE TE ARKAVE TE PENSIONEVE, PERVEC SIGURIMEVE SHOQERORE TE DETYRUESHME	500.000	90.000	100.000	51.600	35.200	29.700	17.000
67			AKTIVITETET NDIHMESE TE NDERMJETESIMIT FINANCJAR							
			DHE TE SIGURIMIT	150.000	80.000	90.000	51.600	35.200	29.700	17.000
			SEKSIONI K: PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA, DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERRMARJEVE							
70			AKTIVITETE E PASURIVE TE PATUNDESHME	150.000	80.000	90.000	64.800	44.000	37.070	17.000
71			DHENIA ME QIRA E PAJISJEVE PA OPERATOR, DHE E ARTIKUJVE PERSONALE DHE SHTEPLAKE	150.000	80.000	90.000	54.000	44.000	37.070	17.000
72			AKTIVITETE INFORMATIKE DHE AKTIVITETE TE LIDHURA ME TO							

72.1	Rekomandime me ane te sistemit informatik	150.000	80.000	90.000	48.000	33.000	29.700	17.000
72.2	Realizimi i programeve informatike	150.000	80.000	90.000	48.000	33.000	29.700	17.000
72.5	Mirembajtja dhe riparimi i makinave, pajisjeve te zyrave dhe te mjeteve	150.000	80.000	90.000	48.000	38.500	29.700	17.000
73	KERKIME - APLIKIME EKSPERIMENTALE	150.000	80.000	90.000	48.000	38.500	29.700	17.000
74	AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMEVE QE KRYHEN KRYESISHT PER NDERMARJET							
74.1	Aktivite juridike, kontabile etj nga shoqeri te inkuorporuara	200.000	80.000	100.000	38.400	26.400	22.220	17.000
74.1.1	Aktivite juridike, kontabile nga ortakeri	70.000	60.000	50.000	45.000	30.000	29.000	17.000
74.2	Aktivite te arkitektures dhe te inxhinjerise	200.000	80.000	100.000	38.400	26.400	22.220	17.000
74.4	Publikimi (reklamati, afisheet, vitrinat etj)	150.000	80.000	90.000	38.400	26.400	22.220	17.000
74.6	Aktivite te hetimit dhe te ruajtjes se objekteve dhe personave	150.000	80.000	90.000	30.000	22.000	17.600	17.000
74.7	Aktivite te pastrimit te ndertesave	150.000	80.000	90.000	38.400	26.400	22.220	17.000
75	ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES; SIGURIMI SHOQEROR I DETYRUAR	150.000	80.000	90.000	48.000	33.000	27.830	17.000

KATEGORIA II Rrethet: Durres, Elbasan, Korce, Vlore, Shkoder, Fier, Gjirokastr

SEKSIONI J/K: NDERMJETESIMI FINANCIAR, PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA,DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERMARJEVE

	SEKSIONI J: NDERMJETESIMI FINANCIAR							
65	NDERMJETESIMI FINANCIAR PERVEC AKTIVITETEVE TE SIGURIMIT DHE ARKAVE TE PENSIONEVE							
65.1	Ndermjetesimi monetar	140.000	80.000	80.000	47.300	33.600	28.350	15.000
65.2	Ndermjetesime te tjera financiare	90.000	50.000	60.000	47.300	33.600	28.350	15.000
66	AKTIVITETE TE SIGURIMIT, DHE TE ARKAVE TE PENSIONEVE, PERVEC SIGURIMEVE SHOQERORE TE DETYRUESHME	90.000	50.000	60.000	47.300	33.600	28.350	15.000
67	AKTIVITETET NDIHMESE TE NDERMJETESIMIT FINANCIAR DHE TE SIGURIMIT	200.000	80.000	80.000	47.300	33.600	28.350	15.000
	SEKSIONI K : PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA, DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERMARJEVE							

70		AKTIVITETE E PASURIVE TE PATUNDESHME	90.000	50.000	60.000	59.400	42.000	35.385	15.000
71		DHENIA ME QIRA E PAJISJEVE PA OPERATOR, DHE E ARTIKUJVE PERSONALE DHE SHTEPIAKE	90.000	50.000	60.000	49.500	42.000	35.385	15.000
72		AKTIVITETE INFORMATIKE DHE AKTIVITETE TE LIDH	90.000	50.000	60.000	44.000	31.500	28.350	15.000
	72.1	Rekomandime me ane te sistemit informatik	90.000	50.000	60.000	44.000	31.500	28.350	15.000
	72.2	Realizimi i programeve informatike	90.000	50.000	60.000	44.000	31.500	28.350	15.000
	72.5	Mirembajtja dhe riparimi i makinave, pajisjeve te zyrave dhe te mjete	90.000	50.000	60.000	44.000	36.750	28.350	15.000
73		KERKIME - APLIKIME EKSPERIMENTALE	90.000	50.000	60.000	44.000	36.750	28.350	15.000
74		AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMEVE QE KRYHEN KRYESISHT PER							
		NDERMARJET							
	74.1	Aktivite juridike, kontabile etj nga shoqeri te inkuorpuara	100.000	50.000	80.000	35.200	25.200	21.210	15.000
	74.1.1	Aktivite juridike, kontabile etj nga ortakeri	60.000	50.000	50.000	35.000	25.000	21.000	15.000
	74.2	Aktivite te arkitektures dhe te inxhinjerise	100.000	50.000	80.000	35.200	25.200	21.210	15.000
	74.4	Publikimi (reklamat, afisheet, vitrinat etj)	90.000	50.000	60.000	35.200	25.200	21.210	15.000
	74.6	Aktivite te hetimit dhe te ruajtjes se objekteve dhe personave	90.000	50.000	60.000	27.500	21.000	16.800	15.000
	74.7	Aktivite te pastrimit te ndertesave	90.000	50.000	60.000	35.200	25.200	21.210	15.000
75		ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES; SIGURIMI SHOQEROR I DETYRUAR	90.000	50.000	60.000	44.000	31.500	26.565	15.000

KATEGORIA III: Rrethet e tjera

SEKSIONI J/K: NDERMJETESIMI FINANCIAR, PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA,DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERMARJEVE

		SEKSIONI J: NDERMJETESIMI FINANCIAR							
65		NDERMJETESIMI FINANCIAR PERVEC AKTIVITETETEVE							
		TE SIGURIMIT DHE ARKAVE TE PENSIONEVE							
	65.1	Ndermjetesimi monetar	60.000	35.000	40.000	43.000	32.000	27.000	14.000
	65.2	Ndermjetesime te tjera financiare	60.000	35.000	40.000	43.000	32.000	27.000	14.000
66		AKTIVITETE TE SIGURIMIT, DHE TE ARKAVE TE PENSIONEVE, PERVEC SIGURIMEVE SHOQERORE TE DETYRUESHME	60.000	35.000	40.000	43.000	32.000	27.000	14.000
67		AKTIVITETET NDIHMESE TE NDERMJETESIMIT FINANCIAR							

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndaria	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	KATEGORIA I Rrethi TIRANE							Puntore te pakualifiku ar
				Drejtor Administrator		Drejtues te degeve, njesive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialiste ne zbatim	Puntore te kualifikuar		
				DTM	Subjekte te tjera	DTM	Subjekte te tjera				
			SEKSIONI M: ARSIMI								
80			ARESIMI								
	80.1		Aktivitete te aresimit fillor	150.000	80.000	90.000	30.000	22.000	20.000	17.000	
	80.2		Aktivitete te aresimit te mesem	150.000	80.000	90.000	31.000	25.000	21.000	17.000	
	80.3		Aktivitete te aresimit te larte	200.000	80.000	130.000	36.000	26.400	22.000	17.000	
	80.4		Aktivitete te kurseve te vazhdueshme dhe aktivitete te	150.000	80.000	90.000	40.800	28.600	23.760	17.000	

KATEGORIA II Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkoder, Fier, Gjirokastr										
			SEKSIONI M: ARSIMI							
80			ARESIMI							
	80.1		Aktivite te aresimit fillor	80.000	50.000	60.000	26.000	20.000	19.000	15.000
	80.2		Aktivite te aresimit te mesem	80.000	50.000	60.000	27.500	21.000	19.110	15.000
	80.3		Aktivite te aresimit te larte	150.000	50.000	100.000	33.000	25.200	21.000	15.000
	80.4		Aktivite te kurseve te vazhdueshme dhe aktivite te	80.000	50.000	60.000	37.400	27.300	22.680	15.000

KATEGORIA III: Rrethet e tjera										
			SEKSIONI M: ARSIMI							
80			ARESIMI							
	80.1		Aktivite te aresimit fillor	60.000	35.000	40.000	25.000	19.000	19.000	14.000
	80.2		Aktivite te aresimit te mesem	60.000	35.000	40.000	26.000	19.500	19.100	14.000

80.3		Aktivite te aresimit te larte	60.000	35.000	40.000	30.000	24.000	20.000	14.000
80.4		Aktivite te kurseve te vazhdueshme dhe aktivite te	60.000	35.000	40.000	34.000	26.000	21.600	14.000

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Drejtor Administrator		Drejftues te degeve, njesive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialiste ne zbatim	Puntore te kualifikuar	Puntore te kualifi kuar
				VIP	Subjekte te tjera	VIP	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I Rrethi TIRANE										
SEKSIONI N: SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE										
85										
	85.1		SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
			Aktivitete per kujdesin e shendetit							
	85.12		Aktivitete mjeksore ambulatorie (klinike private, ambulance, sh	200.000	80.000	150.000	40.800	28.600	23.760	17.000
	85.13		Aktivitete te praktikës ambulatorie dentare	200.000	80.000	150.000	40.800	28.600	23.760	17.000
	85.3		Veprimtari sociale	150.000	80.000	90.000	40.800	28.600	22.000	17.000

KATEGORIA II Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkoder, Fier, Gjirokastr										
			SEKSIONI N: SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
85			SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
	85.1		Aktivitete per kujdesin e shendetit							
		85.12	Aktivitete mjeksore ambulatorie (klinike private, ambulance, sh	120.000	50.000	80.000	37.400	27.300	22.680	15.000
		85.13	Aktivitete te praktikës ambulatorie dentare	120.000	50.000	80.000	37.400	27.300	22.680	15.000
	85.3		Veprimtari sociale	90.000	50.000	60.000	37.400	27.300	21.000	15.000

KATEGORIA III: Rrethet e tjera										
			SEKSIONI N: SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							
85			SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE							

PAGA REFERUESE MUJORE PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE DHE TATIMIT MBI TE ARDHURAT PERSONALE PER PUNEMARRESIT QE PUNOJNE NE SEKTORIN PRIVAT SIPAS NOMENKLATURES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Ndarja	Grupi	Klasa	VEPRIMTARITE EKONOMIKE	Drejtor Administrator		Drejtues te degeve, njesive dhe specialiste me arsim te larte		Teknike dhe specialiste ne zbatim	Puntore te kualifiku ar	Puntore te kualifi kuar
				VIP	Subjekte te tjera	VIP	Subjekte te tjera			
KATEGORIA I Rrethi TIRANE										
			SEKSIONI O : AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMIT KOLEKTIV,							
			SOCIAL DHE INDIVIDUAL							
90			PASTRIMI, HEQJA E MBETURINAVE , TRAJTIMI I HEDHURINAVE							
			DHE AKTIVITETE TE TJERA TE NGJASHME	150.000	80.000	90.000	36.000	27.500	24.090	17.000
91			AKTIVITETE TE ORGANIZATAVE TE NDRYSHME SHOQERORE							
	91.1		Aktivitete te organizatave ekonomike	150.000	80.000	90.000	40.800	28.600	24.090	17.000
	91.2		Aktivitete te sindikateve te punes.	150.000	80.000	90.000	30.000	22.000	20.020	17.000
	91.3		Aktivitete te tjera te shoqerive	150.000	80.000	90.000	30.000	22.000	20.020	17.000
92			AKTIVITETE DEFRIMI, KULTURORE DHE SPORTIVE							
	92.1		Aktivitete kinematografike	150.000	80.000	90.000	34.800	24.200	20.020	17.000
	92.2		Aktivitete te radios dhe te televizionit							
	92.2.1		TV Kombetar	220.000	80.000	130.000	40.800	28.600	24.090	17.000
	92.2.2		TV Lokal	180.000	80.000	110.000	40.800	28.600	24.090	17.000
	92.3		Aktivitete te tjera te cfaqjeve	150.000	80.000	90.000	34.800	24.200	20.020	17.000
	92.6		Aktivitete sportive	150.000	80.000	90.000	34.800	24.200	20.020	17.000
	92.7		Aktivitete argetuese	150.000	80.000	90.000	44.400	30.800	25.300	17.000
93			AKTIVITETE TE SHERBIMEVE PERSONALE							
	93.01		Larja dhe pastrimi i tekstileve gezofrave, tapeteve	150.000	80.000	90.000	36.000	26.400	22.220	17.000
	93.02		Floktoret dhe institutet e tjera te bukurise	150.000	80.000	90.000	36.000	26.400	22.220	17.000

93.03	Sherbimet funebre dhe aktivitete te tjera te lidhur ne to	150.000	80.000	90.000	36.000	26.400	22.220	17.000
93.04	Aktivitete te mirembajtjes trupore (banjat termale, banja avulli, etj)	150.000	80.000	90.000	36.000	26.400	22.220	17.000

KATEGORIA II Rrethet: Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkoder, Fier, Gjirokastr

	SEKSIONI O : AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMIT KOLEKTIV ,							
	SOCIAL DHE INDIVIDUAL							
90	PASTRIMI, HEQJA E MBETURINAVE , TRAJTIMI I HEDHURINAVE							
	DHE AKTIVITETE TE TJERA TE NGJASHME	90.000	50.000	60.000	33.000	26.250	22.995	15.000
91	AKTIVITETE TE ORGANIZATAVE TE NDRYSHME SHOQERORE							
91.1	Aktivitete te organizatave ekonomike	90.000	50.000	60.000	37.400	27.300	22.995	15.000
91.2	Aktivitete te sindikateve te punes.	90.000	50.000	60.000	27.500	21.000	19.110	15.000
91.3	Aktivitete te tjera te shoqerive	90.000	50.000	60.000	27.500	21.000	19.110	15.000
92	AKTIVITETE DEFRIMI, KULTURORE DHE SPORTIVE							
92.1	Aktivitete kinematografike	90.000	50.000	60.000	31.900	23.100	19.110	15.000
92.2	Aktivitete te radios dhe te televizionit							
92.2.1	TV Kombetar	150.000	80.000	60.000	37.400	27.300	22.995	15.000
92.2.2	TV Lokal	100.000	70.000	60.000	37.400	27.300	22.995	15.000
92.3	Aktivitete te tjera te cfaqjeve	90.000	50.000	60.000	31.900	23.100	19.110	15.000
92.6	Aktivitete sportive	90.000	50.000	60.000	31.900	23.100	19.110	15.000
92.7	Aktivitete argetuese	90.000	50.000	60.000	40.700	29.400	24.150	15.000
93	AKTIVITETE TE SHERBIMEVE PERSONALE							
93.01	Larja dhe pastrimi i tekstileve gezofrave, tapeteve	90.000	50.000	60.000	33.000	25.200	21.210	15.000
93.02	Floktoret dhe institutet e tjera te bukurise	90.000	50.000	60.000	33.000	25.200	21.210	15.000
93.03	Sherbimet funebre dhe aktivitete te tjera te lidhur ne to	90.000	50.000	60.000	33.000	25.200	21.210	15.000
93.04	Aktivitete te mirembajtjes trupore (banjat termale, banja avulli, etj)	90.000	50.000	60.000	33.000	25.200	21.210	15.000

KATEGORIA III: Rrethet e tjera

	SEKSIONI O : AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMIT KOLEKTIV ,							
	SOCIAL DHE INDIVIDUAL							
90	PASTRIMI, HEQJA E MBETURINAVE , TRAJTIMI I HEDHURINAVE							
	DHE AKTIVITETE TE TJERA TE NGJASHME	60.000	35.000	40.000	30.000	25.000	21.900	14.000

UDHËZIM
Nr.7, datë 3.5.2007

MBI KONTROLLIN DHE MONITORIMIN E SUBJEKTEVE
QË MBJELLIN KËRP INDUSTRIAL

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 9 të ligjit nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar, Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

UDHËZOJNË:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Brendshme, të cituara më poshtë “Palët”, nëpërmjet këtij udhëzimi të përbashkët, synojnë rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimin sa më të mirë të veprimtarisë së strukturave të specializuara të tyre, për të luftuar me efikasitet kultivimin e bimëve narkotike në përgjithësi, si dhe për të kontrolluar e monitoruar kultivimin e kërpit industrial në veçanti, me qëllim parandalimin e devijimit nga destinacioni të këtij aktiviteti dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të atyre subjekteve që veprojnë në kundërshtim me legjislacionin në këtë fushë.

2. Strukturat përkatëse qendrore dhe vendore të dy palëve dhe konkretisht: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, drejtoritë e policisë dhe drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit në qarqe; komisaritet e policisë dhe zyrat e bujqësisë në rrethe, të shkëmbejnë informacione dhe të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e përmendura në pikën 1.

3. Shërbimi karantinor-fitosanitar i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të bllokojë importimin e farave të ndryshme të kërpit industrial, pa leje të veçantë të lëshuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve. Në rast nevojë, inspektorët e karantinës –fitosanitar, në bashkëpunim me inspektorët e farave dhe fidanëve, të kërkojnë ndihmën e strukturave të policisë kufitare.

4. Në pikat e kalimit të kufirit, inspektorët e karantinës-fitosanitar dhe në doganat pritëse, inspektorët farave e fidanëve të rretheve, të plotësojnë për çdo kontingjent të farës së kërpit industrial dokumentacionin bazë të materialit mbjellës bimor. Për rastet e dyshimta në dokumentacionin e origjinës për farën e kërpit industrial të bëhet bllokimi i kontingjentit, duke kërkuar verifikimin nga organet e specializuara të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe të Policisë së Shtetit.

5. Inspektorët e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe ata të rretheve të ushtrojnë kontrolle sistematike në pikat e shitjes, të bllokojnë e sekuestrojnë çdo kontingjent që nuk vërteton origjinën e farës së kërpit industrial mbi qëllimin e përdorimit të saj dhe në rast nevojë të kërkojnë mbështetje nga Policia e Shtetit.

6. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të evidentojë të gjitha sasitë e farës së kërpit industrial që futen zyrtarisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, zonat ku do të përdoret dhe sipërfaqet që do të mbillen. Në këtë proces monitorimi të bashkërendohet puna me Policinë e Shtetit.

7. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të informojë Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për çdo kontingjent të farës që importohet dhe zonat ku do të mbillet. Drejtoria përkatëse e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë drejtorinë përkatëse të Ministrisë së Brendshme.

8. Importi i farës së kërpit industrial, lejohet vetëm me leje të veçantë për çdo kontingjent të lëshuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Leja për importin e farës së kërpit industrial jepet vetëm kur personi ose subjekti plotëson kushtet sipas nenit 9 të ligjit nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar dhe formularin për vetëdeklarimin mbi të dhënat identifikuese, origjinën e farës, adresën e eksportuesit dhe qëllimin e importimit të tij. Gjithashtu përpara miratimit të lejeve nga Ministri për importimin e farës së kërpit industrial, të kërkohet një mendim nga Policia e Shtetit me qëllim për të parandaluar aktivizimin në këtë aktivitet të personave me precedent kriminal në fushën e kultivimit të bimëve narkotike apo të prodhimit e shitjes së drogave.

9. Inspektorët e farave dhe fidanëve në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe personat e ngarkuar në zyrat e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit në rrethe, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të informojnë fermerët dhe subjektet mbi legjislacionin në këtë fushë. Në bashkëpunim me strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit të organizojnë kontrole dhe inspekte gjatë fazave të ndryshme të procesit të prodhimit dhe të merren mostra me procesverbal, të cilat të dërgohen nga specialistët e Policisë së Shtetit në Institutin e Policisë Shkencore për ekzaminime. Në rast se nga ekzaminimi del një përqindje më e lartë e TCH-së nga ajo që lejon ligji, atëherë Policia e Shtetit, në bashkëpunim me prokurorinë marrin masat përkatëse ndaj personave përgjegjës. Gjithashtu të monitorohet edhe destinacioni i produktit të prodhuar.

10. Brenda një muaji nga nënshkrimi i këtij udhëzimi, të gjitha këto struktura të kenë caktuar e të kenë shkëmbyer të dhënat për pikat e kontaktit dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit. Në vazhdimësi, çdo ndryshim i pikave të kontaktit apo mënyrës së komunikimit t'i njoftohet menjëherë palës tjetër.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

UDHËZIM
Nr.7, datë 7.5.2007

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË SHPRONËSIMEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 8 të ligjit nr.9601, datë 28.7.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006"" për përdorimin e fondit të shpronësimeve

UDHËZOJ:

1. Ministrinë dhe institucionet qendrore të paraqesin në Ministrinë e Financave - Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit kërkesën për shpronësim, e cila duhet të ketë bashkëngjitur vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësimin e kërkuar.

2. Ministria e Financave e miraton kërkesën në rast se shpronësimi bëhet për projekte të programeve prioritare të Qeverisë dhe nëse fondet, në llogarinë "Fondi i shpronësimeve" pranë Bankës së Shqipërisë, janë të mjaftueshme.

3. PAGESA E TË SHPRONËSUARVE TË BËHET SI VIJON:

- Ministrinë dhe institucionet qendrore përkatëse, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave, për çdo individ apo subjekt të shpronësuar krijon dosjen përkatëse, në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik".

- Me përfundimin e kompletimit ligjor të dosjes, ministrinë dhe institucionet qendrore përkatëse hartojnë listëpagesën për dosjet e përfunduara (sipas formatit bashkëngjitur këtij udhëzimi).

- Listëpagesa e miratuar zyrtarisht nga titullari i ministrisë ose institucionit qendror i bashkëngjitet kërkesës zyrtare dhe paraqitet për pagesë pranë Ministrisë të Financave.

4. Ministri i Financave, bazuar në listëpagesën bashkëngjitur kërkesës, lëshon urdhërpagesën për Bankën e Shqipërisë, e cila kryen transfertat në llogaritë personale bankare të të shpronësuarve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

✓

[illegible]

Personat e autorizuar per plotesim dosje dhe likuidim

Emri Mbiemri	Detyra funksionale	Firma
--------------	--------------------	-------

Nr	1	2	3	4	5
----	---	---	---	---	---

MIRATOHET

Titullari Vula

URDHËR
Nr.155, datë 11.5.2007

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(OMP NARTË)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Nartë, që i bashkëngjitet këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

VENDIM
Nr.585, datë 27.4.2007

MBI REDUKTIMIN E KOHËS SË VLEFSHMËRISË SË LICENCËS SË SUBJEKTIT
TELEVIZIV PRIVAT KOMBËTAR “TV ARBËRIA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Ledi Bianku	Kryetar
Mesila Doda (Demi)	Zëvendëskryetare
Frano Kulli	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Alban Karapici	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Mbi reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat kombëtar “TV Arbëria”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 137 dhe 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimet nr.532, datë 20.11.2006 dhe nr.567, datë 21.2.2007 të KKRT-së,

VËREN SE:

Me vendimin nr.567, datë 21.2.2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vendosi të reduktojë paraprakisht kohën e vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat kombëtar “TV Arbëria”, për një afat kohor 1 (një)-vjeçar, për shkaqet e parashtruara në vendim.

Në mbështetje të pikës 2 të vendimit dhe nenit 137/3, sipas të cilit “Për t’i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi”, subjekti “TV Arbëria” kishte të drejtë që brenda një afati 30-ditor të depozitonte mendimin e tij lidhur me këtë vendim.

Me shkresën e datës 1.3.2007 “TV Arbëria” ka depozituar ankimin përkatës, duke kërkuar

revokimin e vendimit nr.567, datë 21.2.2007 të KKRT-së, sipas arsytimit si më poshtë vijon:

1. “Nga monitorimi juaj, rezulton të jenë transmetuar 4 ose 5 edicione informative nga TVA-ja. Ky numër edicionesh plotëson kërkesat e ligjit dhe të licencës së lëshuar nga KKRT-ja. Pra struktura e programeve nuk mund të ketë ndryshuar, pasi ndryshim do të përbënte vetëm dalja jashtë këtyre kufijve. Vërejtja juaj për mostratransmetimin e filmave televizivë nga TVA-ja nuk është e bazuar në ligj. Për më tepër, ju nuk i referoheni ndonjë dispozite ligjore që është shkelur në këtë rast. Përsa i përket ritransmetimeve, si programe muzikore edhe spektakle ose emisione për fëmijë, ato nuk mund të konsiderohen si ndryshim i strukturës programore të TVA-së, pasi në licencën e saj nuk vendoset ndonjë detyrim për kohëzgjatjen e programeve ditore të përsëritura dhe as përcaktohet një strukturë programore që të përmbajë ndarjen e kohëzgjatjes së programeve të reja dhe atyre të përsëritura.

2. Periudha e monitorimit të programeve të TVA-së është shumë e afërt në kohë me datën e marrjes së vendimit për sanksionin e parë, atë të paralajmërimit. Në nenin 137/1 ligji kërkon që KKRT-ja të vendosë një afat për ndreqjen e shkeljes nga operatori. Në fakt, KKRT-ja nuk e ka bërë një gjë të tillë.

3. Në kushtet kur sanksioni i paralajmërimit nuk ka marrë formë të prerë dhe pasojat e tij nuk janë aktivizuar, mendojmë se KKRT-ja duhet të ndalojë marrjen e një sanksioni më të rëndë për të njëjtën shkelje”.

Lidhur me pretendimet e mësipërme të subjektit televiziv privat kombëtar “TV Arbëria” KKRT-ja vëren se:

- Në vendimin nr.567, datë 21.2.2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit nuk e lidh ndryshimin e strukturës programore me numrin e edicioneve informative të transmetuara nga TVA-ja, ashtu sikurse, në marrjen e këtij vendimi, KKRT-ja nuk është mbështetur vetëm në faktin se TVA-ja nuk transmeton filma artistikë.

Kujtojmë se në kushtet e licencës së subjektit TVA, është saktësuar një përqindje e caktuar për transmetim filmash artistikë, një detyrim ky që ende nuk po zbatohet. Gjithashtu, pretendimi se KKRT-ja nuk i referohet ndonjë strukture të specifikuar, që të reflektojë përqindjen e programeve të përsëritura ose të reja nuk qëndron, pasi, në momentin kur subjekti TVA është licencuar si operator televiziv privat kombëtar, ka depozituar pranë KKRT-së një strukturë programore të caktuar. Në të njëjtën kohë, mbështetur në nenin 40 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “...nuk konsiderohen programe ritransmetimet thjesht përsëritëse ose ato që janë me figurë fikse...”.

Përsa i përket pretendimit të dytë, KKRT-ja vëren se edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi pika 1 e nenit 137/3 të ligjit përcakton se “Kur inspektorët e KKRT-së vërtetojnë se i licencuari ka shkelur dispozitat e këtij ligji, kushtet e licencës dhe rregulloret e miratuara nga KKRT-ja, kanë të drejtë të vendosin gjobë, në zbatim të nenit 137/4 të këtij ligji dhe të kërkojnë nga i licencuari marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e saj. Në rastin konkret, sanksioni i paralajmërimit sipas vendimit nr.532, datë 20.11.2006 është marrë nga KKRT-ja në zbatim të nenit 137 të ligjit nr.8410, dhe jo nga inspektorët e KKRT-së, ashtu sikurse parashikohet në nenin 137/4 të ligjit nr.8410. KKRT-ja vendos sanksione në zbatim të nenit 137, ndërsa inspektorët e KKRT-së vendosin sanksione në zbatim të nenit 137/4 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Mbështetur në pikën 2 të vendimit nr.532, datë 27.11.2006 KKRT-ja i ka bërë me dije “TV Arbëria” të marrë të gjitha masat në funksion të zbatimit dhe respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.8410, datë 30.9.1998, pasi në të kundërt sanksionet që do të ndërmerren nga KKRT-ja, do të përshkallëzohen.

- Lidhur me pretendimin e fundit të subjektit “TV Arbëria”, KKRT-ja konstaton se, mbështetur në nenin 111 të Kodit të Procedurave Administrative, “aktet administrative hyjnë në fuqi nga dita e miratimit të tyre”. Bazuar në nenin 131 të Kodit të Procedurave Administrative “hyrja në fuqi e akteve mund të pezullohet...nga gjykata, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile”. Sqarojmë se deri në këto momente, nga ana e gjykatës, nuk ekziston ndonjë vendim që të pezullojë vendimin nr.532, datë 27.11.2006 të KKRT-së.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21 të nenit 137 dhe 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimeve nr.532, datë 20.11.2006 dhe nr.567, datë 21.2.2007 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. Të reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat kombëtar “TV Arbëria” për një afat kohor 1 (një)-vjeçar.
2. Afati i licencës nr.02/TVK përfundon më datë 3.1.2008.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr.587, datë 27.4.2007

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
PRIVAT “APT”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të KKRT-së nr.421, datë 27.2.2006, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.21, datë 30.3.2004, ndryshuar me vendimin nr.503, datë 17.7.2006, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për zgjerimin e zonës së licencimit për televizionin kabllor privat “APT” me nr.licence 039/RTVK në qytetet e Sarandës dhe të Pukës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr.30, datë 11.5.2007

PËR DISA SHITESA NË RREGULLOREN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë

elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 21 të “Rregullave të procedurave të licencimit”, miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2007, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për një shtesë në rregullat e procedurave të licencimit,

VENDOSI:

1. Në rregulloren e procedurave të licencimit, miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve, të shtohet në nenin 10 pika 2 paragrafi me përmbajtjen si më poshtë:

“- Në rastet kur personat aplikojnë për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimit të energjisë elektrike pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave “Për fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të objektit...”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrton rregullsinë e dokumenteve të tjera sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, vendos fillimin e procedurave të licencimit.”.

2. Në rregulloren e procedurave të licencimit, miratuar me vendimin nr.21, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve, të shtohet në nenin 14 pika 2 paragrafi me përmbajtjen si më poshtë:

“- Marrja e vendimit përfundimtar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s për rastin e trajtuar në nenin 10 pika 2 paragrafi i fundit, do të kryhet me paraqitjen në ERE të marrëveshjes së koncesionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 17.5.2007
Doli nga shtypi më 18.5.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 72 lekë